



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 722/3 prot.

Vlorë, më 06.06.2018

VENDIM

Nr. 28, datë 22.05.2018

PËR

SHFUQIZIMIN E PARAGRAFIT TË PARË TË PIKËS 1 TË GËRMËS A DHE PARAGRAFIN E PARË TË PIKËS 2 TË GËRMËS A TË VENDIMIT TË SENATIT AKADEMIK NR. 54 DATË 20.04.2017 "PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË UNIVERSITETIN " ISMAIL QEMALI" VLORË"

Mbështetur në nenin 113 të Kodit të Proçedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë, në referencë të pikës 3 të nenit 46 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.05.2018

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e paragrafit të parë të pikës 1 të gërmës A të Vendimit të Senatit Akademik nr. 54 datë 20.04.2017 pasi është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 46 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"
2. Shfuqizimin e paragrafit të parë të pikës 2 të gërmës A të Vendimit të Senatit Akademik nr. 54 datë 20.04.2017 pasi është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 46 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë."
3. Formulimin e paragrafit të parë të pikës 1 të gërmës A të Vendimit të Senatit Akademik nr. 54 datë 20.04.2017 si më poshtë vijon:

*"KSBCI përbëhet nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik, për një mandat dyvjeçar me të drejtë rizgjedhje".*

4. Formulimin e paragrafit të parë të pikës 2 të gërmës A të Vendimit të Senatit Akademik nr. 54 datë 20.04.2017 si më poshtë vijon:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**SENATI AKADEMIK**

*"KMSI përbëhet nga 7 anëtarë nga të cilët 6 janë personel akademik dhe 1 student, që vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik, për një mandat dyvjeçar me të drejtë rizgjedhje".*

**1. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Roland ZISI**

